



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM Nr. 35 datë 18.07.2011

PËR EMËRIMIN E EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË  
SH.A "UJËSJELLËS KANALIZIME" KORÇË

Këshilli Bashkiak Korçë, në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Neni 135/ç, të Statutit të Sh.A UKKO Neni 10/ç, neni 25, si dhe të Ligjit Nr.10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" Neni 42, pasi u njoh me kërkesën për emërim eksperti të dërguar me shkresë nga Drejtoria e Sh.A UKKO,

VENDOSI


1. Të emërojë, për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore 2011 të Sh.A UKKO, si Ekspertë Kontabël të Autorizuar :

1. Shoqërinë "TELO –AUDITING" Sh.p.k
2. Ilda Ekonomi

Shoqëria para fillimit të punës harton me Ekspertët një projekt-marrëveshje për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave të verifikimeve, kontrolleve, raportimeve etj, për përmbushjen e misionit, orët e punës të parashikuara si dhe honorarin gjithsej.

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

  
ILIRIAN PENDAVINJI